



STATUT
I
INSTITUCIONIT TË ARSIMIT
TË LARTË PRIVAT

Shkolla e Lartë Private "Logos"

Kreu i I

Dispozita të Përgjithshme

Neni 1

Pozita juridike

1. "Shkolla e Lartë Private "Logos" është Institucion i Arsimit të Lartë Privat, i krijuar në bazë të ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007, "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzimit nr. 11 datë 28.02.2011, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës "Për Procedurat dhe Dokumentacionin për Hapjen e një Institucioni Privat te Arsimit te Larte, Programeve te Studimit Universitar ne Ciklin e Pare dhe Ciklin e Dyte, Programeve te Studimeve jo Universitare, te Natyrës Profesionale si dhe Procedurat për Pezullimin dhe Revokimin e Licencës. akteve të tjera nënligjore dhe licencës së dhënë me vendimin Nr. 1055, datë 29.07.2009, të Këshillit të Ministrave "Për licencimin e Shkollës së Lartë private "Logos".
2. Shkolla e Lartë Private "Logos" administrohet nga Fondacioni "Instituti i Formimit Profesional", i cili është person juridik i njohur me vendimin Nr. 284, datë 26.06.2008, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me qendër në: Rruga e Durrësit, Pallatet "Komfort", përballë Pallatit të Sportit "Asllan Rusi", Tiranë.

Neni 2

Qëllimi

Shkolla e Lartë Private "Logos" ka për qëllim:

1. Të zhvillojë, të transmetojë dhe të zgjerojë dijet me anë të procesit të mësimdhënies.
2. Të përgatisë specialistë të lartë në fushën e shkencave ekonomike, të informatikës së aplikuar dhe teknikes laboratorike mjekësore.
3. Të kryejë studime dhe kërkime në fushën e shkencave ekonomike, të informatikës së aplikuar dhe teknikes laboratorike mjekësore
4. Te ofroje programe te studimeve specializuese afatgjata ne fushat ekonomike, te informatikës se aplikuar dhe te teknikes se larte laboratorike mjekësore, te cilat synojnë një formim profesional dhe japin njohuri për profesione te veçanta ne fushat e lartpërmendura. Këto programe përfshijnë studime teorike ,te kombinuara me aplikime praktike e trajnime profesionale.

Neni 3

Njësitë përbërëse

Shkolla e Lartë Private "Logos" ka në përbërje dy njësi kryesore: Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara. Fakulteti Ekonomik përfshin departamente: Menaxhim Bisnesi, Financë Kontabilitet dhe Menaxhim Turizëm. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara përfshin departamente: Informatikë e Zbatuar, Teknik i Lartë Laboratorësh Mjekësorë dhe Qendër Kërkimi dhe Zhvillimi.

Neni 4

Programi i veprimtarisë

1. Institucioni privat i arsimit të lartë, Shkolla e lartë private "LOGOS" zhvillon veprimtarinë e saj brenda sistemit universitar jo publik.
2. Në përgjigje me objektivat e saj ajo ofron aktualisht programe studimi të ciklit të parë, dhe me pas të ciklit të dytë, e të ciklit të tretë universitar. Këto programe janë të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas sistemit Evropian të transferimit dhe grumbullimit të kreditëve. (ECTS)
3. Në përputhje me interesat e kërkimit shkencor, shkolla harton plane dhe programe mësimore specifike sipas nevojave të ndryshme në fushat ekonomike, informatike dhe të teknikës laboratorike mjekësore.

Neni 5

Organizimi i mësimit

1. Mësimi në Institucionin privat të arsimit të lartë, Shkolla e Lartë private "LOGOS" zhvillohet në gjuhën shqipe.
2. Viti akademik organizohet në dy semestra me nga 15 javë secili dhe me së paku 20 orë mësimore (leksione, seminare, laborator) në javë.
3. Fillimi i procesit mësimor dhe struktura e çdo viti akademik behet me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës.

Neni 6

Parimet bazë

1. Institucioni privat i arsimit të lartë, Shkolla e lartë Private "LOGOS" është një institucion kombëtar, jo publik dhe laik.
2. Mjediset e Shkollës së Lartë Private "Logos" gëzojnë paprekshmëri, e cila garantohet nga ligji Nr. 9741, datë 21. 05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar me ligjin Nr. 10307, date 22.07.2010.

Neni 7

Liria akademike

Institucioni privat i arsimit të lartë, shkolla e lartë private "LOGOS" ka të drejte:

1. Të hartojë dhe të shqyrtojë plane dhe programe mësimore për fushat që mbulon Institucioni.
2. Të hartojë dhe miratojë tekste për studentet që ndjekin programet e studimit në këtë Institucion.
3. Të përzgjedhë personelin akademik dhe administrativ.
4. Të përzgjedhë studentet që regjistrohen në çdo vit akademik.

5. Të anëtarësohet ne shoqata dhe organizata kombëtare dhe ndërkombëtare universitare.
6. Të krijoje lidhje bashkëpunimi me universitetet dhe fakultetet analoge brenda dhe jashtë vendit.
7. Të konkurrojë në programe dhe projekte kombëtare në fusha specifike që lidhen me veprimtarinë e Institucionit.

Neni 8

Detyrimi institucional

Institucioni privat i arsimit te larte, Shkolla e Larte Private “Logos” detyrohet :

1. Të zhvillojë procesin mësimor dhe shkencor sipas standardeve të përcaktuar nga Ministria e Arsimit e Shkencës dhe në përputhje me hapësirën evropiane të arsimit të lartë, si dhe të përgatisë specialiste të nivelit bashkëkohore.
2. Të raportojë në Ministrinë e Arsimit e Shkencës çdo fillim viti akademik, gjendjen financiare te institucionit, përbërjen e stafit akademik dhe tarifat e shkollimit për secilin program studimi, si dhe ne fund te çdo viti akademik, te raportoje për analizën e veprimtarinë mësimore shkencore te institucionit.
3. Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës të kryejë procesin e vlerësimit dhe të akreditimit, i cili bëhet i njohur për publikun.
4. Të përballojë me shpenzimet e veta procesin mësimor dhe shkencor duke siguruar një nivel të lartë profesional dhe institucional për përgatitjen e studentëve. Kostoja e përgatitjes së studentëve është në nivel rritës në krahasim me koston e studentëve në shkollat publike.

KREU II

ORGANET DHE AUTORITETET DREJTUESE TË INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË PRIVAT Shkolla e Lartë private “Logos”

Neni 9

Organet dhe autoritetet drejtuese

Organet drejtuese të shkollës së lartë private janë: Bordi Drejtues i Fondacionit, Senati akademik, Rektorati, Këshilli i Fakultetit, Këshilli i Administrimit dhe Këshilli i Etikës i Shkollës së Lartë “Logos”, ndërsa autoritetet drejtuese janë Rektori, Dekani, Kancelari i Shkollës së Lartë, dhe Përgjegjësi i Departamentit/Qendrës së Kërkimit dhe Zhvillimit.

Krahas organeve drejtuese, është edhe Bordi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

Neni 10

Organi drejtues i Fondacionit është Bordi Drejtues.

Neni 11

Bordi Drejtues

1. Bordi Drejtues është organi kolegjial më i lartë vendimmarrës i Institucionit. Bordi Drejtues mbikëqyr e kontrollon veprimtaritë e Shkollës së Lartë private “Logos” që lidhen me menaxhimin administrativ, financiar, ekonomik dhe të pronave të tij.
2. Bordi Drejtues përbëhet nga Themeluesi dhe anëtarët e përcaktuar në vendimin Nr. 284, datë 26.06.2008, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, për krijimin e Fondacionit “Instituti i Formimit Profesional”.
3. Mënyra e funksionimit të Bordit Drejtues, të drejtat e detyrat e të gjithë anëtarëve përcaktohen në rregulloren e Bordit Drejtues.

Neni 12

Funksionet e Bordit Drejtues

Funksionet kryesore dhe detyrat e Bordit Drejtues janë:

- a) emëron dhe shkarkon Rektorin e Shkollës së Lartë Private “Logos” dhe njofton Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës në Republikën e Shqipërisë;
- b) përcakton kushtet e kontratës së punës për autoritetet drejtuese, personelin akademik dhe personelin tjetër të Shkollës së Lartë Private “Logos”; vendos rreth emërimit, ngritjes në detyrë dhe largimit nga puna të tyre;
- c) miraton buxhetin dhe planin e investimeve, përcakton mënyrat e shpenzimeve dhe kontrollon zbatimin e buxhetit dhe të planit të investimeve të Shkollës së Lartë Private, si dhe çdo veprimtari tjetër financiare;
- d) përcakton pagat e stafit akademik dhe të personelit tjetër;
- e) përcakton kuotat e studenteve me pagesë dhe me bursë;
- f) përcakton pagesën e vitit shkollor, kohën në të cilën duhet të shlyhet pagesa si dhe masën e bursës që do të jepet;
- g) administron pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të Shkollës së Lartë, përdor si garanci pasurinë e Shkollës së Lartë Private “Logos” me qëllim për të marrë kredi;
- h) në rast se vendi i rektorit mbetet vakant, emëron një rektor të ri në detyrë për më së shumti gjashtë muaj;
- i) vendos rreth miratimit ose mosmiratimit në lidhje me donacionet me ose pa kusht që i bëhen Shkollës së Lartë Private “Logos”; si dhe të kryejë procedurat e nevojshme;
- j) vendos rreth bërjes së investimeve, themelimit të sipërmarrjeve dhe përfshirjes në sipërmarrje tashmë të themeluara me qëllim krijimin e të ardhurave për Shkollën e Lartë Private “Logos”; si dhe vendos rreth mënyrës më të mirë të përdorimit të burimeve ekzistuese në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- k) inkurajon programet e bashkëpunimit dhe të shkëmbimit, si dhe kryerjen e aktiviteteve shkencore në bashkëpunim me universitete ose institucione të tjera të ngjashme brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi;
- l) ndjek zbatimin e buxhetit me ndihmën e këshilltarëve të pavarur financiarë ose me ndihmën e firmave të pavarura të auditit;

m) miraton marrëveshjet ose protokollet e bashkëpunimit të paraqitura nga Rektori, me universitetet apo institucionet e tjera brenda dhe jashtë vendit.

Neni 13 **Senati Akademik**

Senati akademik është organ kolegjal vendimmarrës i shkollës së lartë. Ai vendos për problemet më të rëndësishme mësimore shkencore të këtij institucioni. Senati akademik kryesohet nga rektori dhe mblidhet periodikisht.

Anëtarët e Senatit akademik përfaqësojnë personelin mësimor e shkencor dhe duhet të kenë titull dhe/ose grada shkencore. Ata mund të jenë pedagogë të brendshëm ose të jashtëm.

Senati akademik përbëhet nga 7 anëtarë: 6 prej tyre zgjidhen nga personeli akademik, 1 prej tyre është përfaqësues i studentëve. Rektori është Kryetari i Senatit akademik për shkak të detyrës.

Mandati i anëtarëve të Senatit akademik është katër vjet.

Senati akademik mblidhet në seanca të zakonshme, një herë në dy muaj me thirrjen e Kryetarit të Senatit. Rendi i ditës propozohet nga Kryetari i Senatit dhe miratohet nga Senati. Ai mund të mblidhet edhe në seanca të jashtëzakonshme me thirrjen e Kryetarit të Senatit.

Senati akademik ka këto funksione kryesore:

- a) garanton respektimin e parimeve të autonomisë dhe mundësive të barabarta të lirisë akademike e të kërkimit, si dhe të drejtat e studenteve;
- b) miraton planin disa vjeçar të zhvillimit të institucionit dhe programin vjetor të veprimtarive të tij;
- c) vendos me shumicën e votave të anëtarëve të tij projektbuxhetin e institucionit, pasi merr miratimin nga këshilli i administrimit;
- d) miraton ndarjen e burimeve financiare;
- e) miraton projektstatutin e institucionit me dy të tretat e votave të anëtarëve të tij.
- f) miraton rregulloret e institucionit që janë në kompetencë të tij;
- g.) vlerëson dhe miraton programet e reja të studimit, të kërkimit e zhvillimit apo pjesë të tyre si: hapjen ndryshimin ose mbylljen e njësive mësimore ose kërkimore;
- h.) vlerëson garanton dhe mban përgjegjësi për sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion, në përputhje me standardet shtetërore;
- i.) vlerëson veprimtarinë mësimore kërkimore të personelit akademik;
- j.) siguron që kryerja dhe vlerësimi i të gjitha provimeve të bëhet në përputhje me standardet e institucionit, që garantojnë cilësinë dhe transparencën e duhur;
- k.) senati akademik kërkon mendimin e këshillit të administrimit për problemet që janë kompetencë e këtij të fundit;

- l.) miraton raportin vjetor të veprimtarisë mësimore kërkimore si edhe atë financiar në një mbledhje të hapur për të gjithë personelin akademik e administrativ dhe për studentet.

Neni 14 **Rektorati**

1. Rektorati është organ kolegjal ekzekutiv qe përbëhet nga:

- a rektori
 - b. zëvendës rektori/et
 - c . dekani
 - d kancelari i institucionit.
- Rektorati kryesohet nga Rektori

2. Funksionet kryesore te Rektoratit janë

- a. harton planin disa vjeçar të zhvillimit të institucionit.
- b. harton programin vjetor të veprimtarive, si dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit në senatin akademik.
- c. formulon kriteret për shpërndarjen e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore.
- d. parashtron përparësitë mes kërkesave konkurruese për financime mes njësive kryesore të Institucionit.
- e. harton dhe propozon projektbuxhetin për miratim ne senatin akademik
- f. harton planin për investime, kontratat dhe marrëveshjet, qe janë kompetence e tij.
- g. paraqet rekomandime për projektet për programet e studimeve, të kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre.
- h. zbaton të gjitha vendimet e miratuara nga senati akademik dhe këshilli i administrimit.
- i. monitoron dhe publikon rezultatet e vlerësimit të veprimtarive të institucionit.
- j. përgatit marrëveshjen midis institucionit te arsimit të lartë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës pe rregullat e financimit
- k. propozon strukturën e përgjithshme dhe numrin e personelit të institucionit për të gjitha nivelet
- l. përgatit rregulloren e tij te punës, që miratohet nga senati akademik.
- m. rektorati kërkon mendimin e senatit akademik dhe te këshillit te administrimit për aspekte te kompetencës së këtyre te fundit.
- n. rektorati raporton një here ne semestër ne senatin akademik dhe ne këshillin e administrimit.
- o. rektorati harton raportin vjetor të veprimtarisë mësimore kërkimore dhe financiare dhe ia paraqet atë për miratim senatit akademik dhe këshillit të administrimit brenda datës 20 dhjetor të çdo viti.
- p. rektorati ka të drejtë të delegojë kompetencat personelit apo organit tjetër të institucionit në përputhje me rregulloren e tij.

Neni 15

Këshilli i Administrimit

Këshilli i administrimit është organ kolegjal vendimmarrës, qe mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë e Shkollës së Lartë Private "Logos".

Funksionet kryesore të këshillit të administrimit janë:

- a. miraton kriteret për ndarjen e burimeve financiare;
- b. miraton me kërkesën e senatit akademik, projektbuxhetin, me dy të tretat e votave;
- c. vlerëson efikasitetin e përdorimit të fondeve të shkollës së Lartë Private "Logos" dhe të burimeve të tjera financiare të ligjshme;
- d. miraton strukturën dhe numrin e personelit për të gjitha nivelet;
- e. miraton raportin vjetor financiar të paraqitur nga rektorati
- f. miraton rregulloren e brendshme për administrimin financiar dhe kontabilitetin;

Këshilli i administrimit përbëhet nga:

- a. anëtarë të personelit akademik, së paku me gradë shkencore, të zgjedhur nga personeli akademik i çdo njësie kryesore të Shkollës së Lartë private "Logos"
- b. anëtarë të caktuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, përfaqësues nga fushat e shkencës, ekonomisë, kulturës.
- c. një anëtar, përfaqësues i zgjedhur nga këshilli i studentëve të shkollës.
- d. mandati i anëtarëve të këshillit të administrimit është 3 vjet

Neni 16

Këshilli i Etikës

- a) Këshilli i Etikës diskuton probleme të etikës së jetës të arsimit të lartë. Ai i bën propozime Rektorit për këto çështje. Anëtarët e Këshillit të Etikës përzgjidhen nga Rektori, për një periudhë trevjeçare.
- b) Në Këshillin e Etikës bëjnë pjesë një përfaqësues nga secili fakultet, një nga zëvendës rektorët dhe një përfaqësues i studenteve.
- c) Këshilli i Etikës shqyrton dhe merr vendime mbi çështje që i parashtrohen nga personeli akademik dhe administrativ i Shkollës së Lartë Private "Logos" si dhe nga studentët, lidhur me etikën e studentit dhe të personelit akademik dhe administrativ përkatës. Këshilli i Etikës merr vendime duke u bazuar në rregulloret e brendshme të institucionit.
- d) Këshilli i Etikës nxit vendimmarrjen me konsensus, i merr vendimet me shumicë të thjeshtë (50% + 1) dhe i bën propozim rektorit për çdo çështje.
- e) Këshilli i Etikës pranë Shkollës së Lartë Private "Logos" është një strukturë e përhershme që mobilizohet sa herë që ndeshen probleme të kësaj natyre, zgjidhja e të cilave bëhet duke u mbështetur në një mekanizëm shkallëzues, në vartësi të natyrës së problemit të lindur dhe të respektimit të normave të mirësjelljes të tilla si: tërheqje vëmendje, paralajmërim për përjashtim nga shkolla, përjashtim për një vit apo përgjithmonë nga institucioni.

- f) Çdo njeri i nënshtrohet në Këshillin e Etikës një procesi të rregullt e të drejtë gjykimi.
- g) Para se të merret vendimi, Këshilli i Etikës është i detyruar të dëgjojë palët.
- h) Këshilli i Etikës miraton rregulloren e tij të brendshme. Rregullorja e brendshme përcakton në mënyrë të hollësishme të drejtat, detyrat, organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Etikës.

Neni 17

Bordi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

Bordi i Sigurimit të Cilësisë së Brendshme përbën njësinë përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë në Shkollën e Lartë Private "Logos". Bordi kryesohet nga Rektori dhe përbëhet nga Kancelari, Përgjegjësi i Sekretarisë Mësimore, një përfaqësues ekspert i jashtëm dhe një përfaqësues nga organizimet studentore të institucionit.

Bordi i Sigurimit të Cilësisë së Brendshme vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore, kërkimore dhe të veprimtarive administrative të institucionit. Bordi ka akses në të gjitha të dhënat e Institucionit dhe publikon rezultatet e vlerësimit të kryer.

Kompetencat e Bordit të Sigurimit të Cilësisë së Brendshme janë si më poshtë:

1. kryen vlerësimin periodik të programeve të studimit dhe stafit të përfshirë në të;
2. kryen vlerësimin e programeve të reja që do të hapen duke i paraqitur mendim të detajuar Senatit Akademik;
3. kryen vlerësimin me transparencë dhe publikon rezultatin e tij.

Autoritetet Drejtuese

Neni 18

Rektori

Rektori është autoriteti drejtues i shkollës së lartë private. Ai përfaqëson shkollën e lartë dhe vepron në emër dhe për llogari të saj. Rektori emërohet me vendim të Themeluesit të Fondacionit "Instituti i Formimit Profesional" për një periudhë 1 vjeçare me të drejtë riemërimi.

Rektori duhet të ketë titullin "Profesor" ose "Prof/Ass. Dr.". Marrëdhëniet ndërmjet Fondacionit dhe rektorit përcaktohen me kontratë.

Rektori ka këto kompetenca:

- a) drejton dhe përfaqëson institucionin e arsimit të lartë privat "Shkolla e Lartë Private "Logos";
- b) propozon dhe jep pëlqimin për pranimin e personelit akademik të Shkollës së Lartë në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuara nga Senati;
- c) shfuqizon vendimet e Këshillave të Fakulteteve në rast se janë në kundërshtim me ligjin;

- d) lëshon diplomat e përfundimit të studimeve të ciklit të parë dhe të studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë, por nuk ka të drejtën e delegimit të firmës personave të tjerë për këtë kompetencë;
- e) miraton planin akademik të procesit mësimor;
- f) jep leje për hyrjen e forcave të rendit në mjediset e shkollës dhe mund t'i thërrasë ato në rast nevojë.

Neni 19 **Zëvendës rektori**

Zëvendës rektori i cili emërohet me vendim të themeluesit të fondacionit kryen detyra të përcaktuara nga Rektori dhe në mungesë me porosi dhe në emër të tij nënshkruan aktet përkatëse përveç atyre që legjislacioni për arsimin e lartë dhe ky statut i përcakton si ekskluzivitet i Rektorit.

Neni 20 **Kancelari**

Kancelari është specialist me formim të lartë arsimor dhe me përvojë të lartë organizuese.

Kancelari është kreu i strukturës administrative të Shkollës së Lartë dhe përgjigjet para Rektorit dhe Bordit Drejtues për mbarëvajtjen e veprimtarisë së kësaj strukture. Kancelari emërohet nga Themeluesi i Fondacionit "Instituti i Formimit Profesional".

Kancelari ka këto kompetenca:

1. ndjek gjithë veprimtarinë juridiko-administrative në shkallë institucioni dhe përgjigjet përpara Rektorit dhe Bordit Drejtues për mbarëvajtjen e saj;
2. organizon punën për hartimin e projekt-rregulloreve të të gjitha instancave të Shkollës së Lartë.
3. organizon dhe drejton kryerjen e shërbimeve ndaj studentëve në Shkollën e Lartë;
4. ndjek veprimtarinë ekonomiko-financiare të Shkollës së Lartë;
5. koordinon punën me Dekanatet për hartimin e programeve të reja mësimore për cikle të ndryshme studimi;
6. ndjek korrespondencën e institucionit me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe me Institucionet e tjera.
7. kryen detyra të tjera të ngarkuara nga Rektori dhe Bordi Drejtues në lidhje me çështje juridike dhe administrative.

KREU III **ORGANET DREJTUESE NË FAKULTET**

Neni 21

Organet dhe autoritetet drejtuese të fakultetit janë: Dekani dhe Këshilli i Fakultetit

Neni 22

Këshilli i Fakultetit

Këshilli i Fakultetit është organ kolegjal vendimmarrës, që programon e përcakton në bazë të propozimeve të departamenteve, veprimtarinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të fakultetit.

Këshilli i Fakultetit përbëhet nga 5 anëtarë dhe zgjidhet nga stafi akademik. Kryetar i tij është Dekani i fakultetit për shkak të detyrës.

Mandati i anëtarëve të Këshillit të Fakultetit është katërvjeçar.

Këshilli i Fakultetit ka këto kompetenca:

- a) miraton planet mësimore të fakultetit dhe i përcjell ato për miratim te mëtejshëm në Senatin Akademik të Institucionit.
- b) miraton programet mësimore të fakultetit;
- c) miraton tekstet në përdorim të studentëve;
- d) i propozon Senatit akademik strategjinë e zhvillimit të fakultetit;
- e) i propozon Rektorit vendosjen e lidhjeve me shkolla të larta të vendit e të huaja, anëtarësimin në shoqata kombëtare e ndërkombëtare, që shfaqin interes për procesin mësimor dhe shkencor;
- f) miraton rregullat dhe programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë;
- g) miraton propozimet e departamenteve për dhënien e titujve shkencorë.

Neni 23

Departamenti

Departamenti është njësi bazë mësimore-kërkimore që përfshin fusha kërkimi homogjene dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Departamenti mbulon disa disiplina mësimore të ngjashme. Në departament përfshihet gjithë stafi akademik, i brendshëm dhe i jashtëm, sipas disiplinave përkatëse.

Departamenti ka këto kompetenca:

- a. Departamenti nxit bashkërendon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies, kërkimore ose artistike, duke respektuar liritë akademike te personelit akademik dhe te drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të departamentit
- b. Departamenti duhet të ketë në përbërjen e tij të paktën 7 anëtarë efektive si personel akademik nder të cilët të paktën 3 duhet të jenë me grada dhe tituj.
- c. Harton dhe shqyrton planet dhe programet mësimore dhe bën ndryshimet e nevojshme;
- d. Shqyrton dhe miraton tekstet mësimore
- e. Ndjek zbatimin e programit mësimor të ciklit të parë sipas planit të miratuar dhe kontrollon cilësinë e mësimdhënies;
- f. Cakton tematikën e punës shkencore dhe kontrollon realizimin e saj;

- g. Ndjek programet e studimit te ciklit te dytë;
- i. Propozon dhënien e titujve shkencore për stafin akademik ne përputhje me legjislacionin ne fuqi;
- h. Organizon mbështetjen dhe këshillimin e studenteve te vitit te fundit lidhur me mundësitë qe ofron departamenti për programet e studimit te ciklit të dytë.

Autoritetet Drejtuese

Neni 24

Dekani

Dekani është autoriteti drejtues kryesor i Fakultetit dhe përfaqësuesi ligjor i tij. Ai emërohet me propozim të Rektorit dhe me miratim të Themeluesit të Fondacionit "Instituti i Formimit Profesional" për një periudhë 1-vjeçare me të drejtë riemërimi. Marrëdhëniet me Fondacionin përcaktohen në kontratën e punës.

Dekani duhet të ketë titullin "Profesor", ose "Profesor i Asociuar", ose gradën "Doktor".

Dekani i Fakultetit ka këto kompetenca:

- a) drejton të gjithë punën mësimore, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor të Fakultetit;
- b) organizon përzgjedhjen e studentëve që pranohen të rinj çdo vit akademik;
- c) propozon Senatit për miratim rregulloren e Fakultetit;
- d) drejton programet e studimit të ciklit të parë, ciklit të dytë dhe të tretë të fakultetit;
- e) miraton komisionet e provimeve;
- f) propozon për përjashtimin nga shkolla të studentëve të shkollës së lartë private me miratim të drejtuesit të shoqërisë.

Neni 25

Përgjegjësi i departamentit

Përgjegjësi i departamentit është autoriteti më i lartë drejtues për njësinë bazë mësimore kërkimore. Përgjegjësi i departamentit zgjidhet nga Dekani ndërmjet anëtarëve të stafit akademik të brendshëm të departamentit, miratohet nga Rektori dhe emërohet nga Themeluesi i fondacionit, për një periudhë njëvjeçare, me të drejtë riemërimi.

Përgjegjësi i Departamentit është përgjegjës për aktivitetin mësimor dhe kërkimor në çdo nivel të departamentit si dhe për kryerjen e rregullt dhe efikase të çdo veprimtarie në atë departament.

Në rastet kur Përgjegjësi i departamenti është në pamundësi të përkohshme për të kryer detyrën e tij, ai ia delegon kompetencat një anëtari të stafit akademik.

Neni 26
Qendra e kërkimit dhe zhvillimit

Qendra e kërkimit dhe zhvillimit është njësi bazë dhe është e organizuar pranë fakulteteve. Qendra e kërkimit dhe zhvillimit kryen veprimtari mësimore-shkencore dhe të zhvillimit.

Përgjegjësi i Qendrës së kërkimit dhe zhvillimit është drejtuesi për njësinë bazë mësimore kërkimore. Ai duhet të jete “profesor” ose “profesor i asociuar” ose “doktor i shkencave” Përgjegjësi i Qendrës së kërkimit dhe zhvillimit zgjidhet nga stafi i brendshëm i fakultetit miratohet nga Rektori dhe emërohet me vendim të Bordit Drejtues, për një periudhë njëvjeçare, me të drejtë riemërimi.

KREU IV

FINANCIMI I SHKOLLËS

Neni 27

Shkolla e Lartë Private “Logos” është institucion i arsimit të lartë privat, me vetëfinancim. Të ardhurat e tij formohen nga tarifat e studentëve, të ardhura të krijuara nga aktivitete të tjera të ligjshme dhe donacione nga Fondacioni.

Institucioni ka të drejtë të pranojë ndihma financiare që lidhen me objektin e veprimtarisë së tij në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Shkolla e Lartë Private “Logos” paguan rregullisht taksat, tatimet dhe detyrimet e tjera ndaj shtetit dhe ndaj të tretëve. Pjesa që mbetet përbën fitimin e saj.

Neni 28

Veprimtaria ekonomike pasqyrohet në bilancet periodike dhe vjetore të institucionit. Ai mban kontabilitet të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

KREU V

CIKLET DHE TITUJT E STUDIMEVE UNIVERSITARE

Neni 29

1. Programet e studimeve ne Shkollën e Lartë private “Logos” organizohen aktualisht në ciklin e parë, dhe në të ardhmen, në ciklin e dytë dhe të tretë.

1.1 Studimet e ciklit të parë.

a. programet e studimit të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuri bazë, mbi metoda dhe parime shkencore të përgjithshme dhe formimin e shprehive të veçanta në profesionet dhe specialitetet që studiohen në shkollë;

b. programet e studimit të ciklit të parë realizohen me 180 kredite evropiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vite akademike;

c. në përfundim të programeve të ciklit të parë nga Sh.L.P "Logos" lëshohet diplomë universitare "Bachelor" në fushën e arsimimit të kryer;

1.2 Studimet e ciklit të dytë:

1.2.1 Programet e studimeve "Master i Shkencave"

a. programet e studimit të ciklit të dytë i pajisin të diplomuarit që zotërojnë diplomën universitare "Bachelor" me njohuri të thelluara teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar brenda një specialiteti që ofron shkollë;

b. programet e studimeve të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite, ku përfshihen 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezen, dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;

c. studentet e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare;

d. në përfundim të programeve të studimit të ciklit të dytë lëshohet diplomë universitare "Master i Shkencave" në fushën e arsimimit të kryer;

1.2.3 Programet e studimeve "Master Profesional"

a. programet e studimeve "Master Profesional" u ofrojnë të diplomuarve, me një diplomë universitare se paku Bachelor" arsimim dhe trajnim të mirëfilltë profesional;

b. programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1.5 Vit akademik (një vit e gjashtë muaj);

c. studentet e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare;

d. në përfundim të këtyre programeve të studimeve lëshohet diplomë universitare "Master Profesional" në fushën e arsimimit të trajnimit profesional të kryer;

e. shkollë e Larte Private "Logos" ka të drejtë të pranojë kandidatë që kanë fituar diplomë "Master Profesional" në studimet e ciklit të dytë për diplomën universitare "Master i shkencave" dhe të vendos kritere për njohjen/transferimin e krediteve të vlefshme të fituara në studimet e masterit që i përgjigjen programit të studimeve të ciklit të dytë.

1.3 Studimet e ciklit të tretë:

1.3.1. Programet e studimeve të doktoratës;

a. programet e studimeve të doktoratës janë programe të studimeve të ciklit të tretë, me karakter plotësisht akademik, që kanë në bazë kërkim shkencor dhe veprimtari krijuese;

b. në studimet e doktoratës pranohen kandidatë që kanë fituar diplomë universitare "Master i Shkencave";

c. këto programe të studimeve zgjasin të paktën 3 vite akademike dhe përfshijnë 60 kredite për studime të organizuara teorike. Pas përfundimit të studimeve teorike, kandidatët zhvillojnë projektin kërkimor dhe përgatisin tezën e doktoraturës. Kandidati duhet që mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare të njohë gjuhën angleze. Kandidatët që nuk arrijnë të përmbushin kriteret e vendosura, nuk klasifikohen për të

vazhduar më tej studimet e doktoratës dhe pajisen me një dëshmi, në të cilën jepen modulet e zhvilluara së bashku me kreditin e grumbulluara dhe vlerësimin e tyre;
d. në përfundim të programeve të studimeve të doktoraturës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor” (Dr)

3. Programet e studimeve të ciklit të parë, të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë janë programe të studimeve universitare.

4. Programet e studimit të ciklit të dytë me pas dhe të tretë në Sh.L.P. “Logos” do të organizohen fazë pas fazë kur institucioni të jetë konsoliduar për studentet e ciklit të parë.

Neni 30

Regjistrimi

1. Pranohen për t’u regjistruar shtetasit shqiptarë ose të huaj që plotësojnë këto kushte:

a) vërtetojnë me dokument zyrtar, mbarimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë shtetit (ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës).

b) dokumentet e nevojshme për regjistrim janë:

- formulari i aplikimit (i plotësuar dhe i vulosur)
- dokumenti i identifikimit (pasaporta ose karta e identitetit)
- fotokopja e dëftesës së pjekurisë e cikluar dhe e noterizuar
- 2 (dy) fotografi dokumentash
- mandati i pagesës së regjistrimit
- numri i identifikimit të AVA
- gjatë regjistrimit studenti nënshkruan me Shkollën e Lartë Private “Logos” kontratën e arsimit
- gjatë të gjithë periudhës së studimeve, studenti duhet të zbatojë ligjet përkatëse të Republikës së Shqipërisë si dhe rregulloren dhe udhëzimet e shkollës.

Neni 31

Transferimet

1. Në përputhje me ligjin Nr. 9741 datë 21/05/2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, institucioni privat i arsimit të lartë Shkolla e Lartë Private “LOGOS” pranon transferime të studentëve në vite të ndërmjetme, që vijnë nga institucione publike ose private të arsimit të lartë, vendas e të huaj, ku drejtohen programe studimi universitare të ciklit të parë ose jouniversitare profesionale dyvjeçare. Institucioni lejon gjithashtu transferimin e studenteve të tij në institucione të tjera të arsimit të lartë vendas apo të huaj.

2. Vlerësimin e plotë ose të pjesshëm të krediteve të fituara për studentët që transferohen nga shkolla të tjera të larta apo institute dyvjeçare parauniversitare e bëjnë komisionet e ekuivalentimit të ngritura në departamentet përkatëse, ndërsa vendimin për njohjen e këtyre krediteve e bën Senati i Universitetit.

3. Studenti që dëshiron të transferohet nga një institucion i arsimit të lartë në shkollën private "Logos" duhet ti paraqesë një kërkesë Rektoratit të kësaj shkolle ku të parashtroje arsyet e transferimit.

4. Së bashku me kërkesën duhet të paraqes një kopje të diplomës së shkollës së mesme (të noterizuar), detyrimet e shlyera në shkollën dërguese me notat përkatëse, një kopje të programeve të lendeve të shlyera, dokumentin e identifikimit si dhe mandatin e pagesës për regjistrim.

Procedura që ndjek transferimi

Dokumenti i përcillet Fakultetit përkatës, i cili bën vlerësimin e lëndëve sipas programeve të tij mësimore, përcakton programin e studimit ku duhet të vazhdojë aplikanti dhe provimet plotësuese që ai do të duhet të shlyejë, nëse është e nevojshme. Rektori pasi merr mendimin e dekanit të fakultetit, njofton aplikantin për pranimin e kërkesës dhe urdhëron regjistrimin e tij. Në çdo rast aplikanti duhet të pranojë pagimin e tarifës nga dita e regjistrimit.

Transferimi nga shkolla e Lartë Private "Logos"

Studenti që dëshiron të transferohet nga Shkolla e Lartë Private "Logos" në një institucion tjetër të arsimit të lartë, duhet ti paraqesë një kërkesë me shkrim Rektoratit të shkollës ku të parashtrojë arsyet e transferimit dhe emrin e institucionit të arsimit të lartë në të cilin kërkon të transferohet. Formulari i kërkesës për transferim tërhiqet në sekretarinë e shkollës.

Me kërkesë të studentit Shkolla e Lartë Private "Logos" detyrohet ta pajisë atë me: Certifikatën e transferimit

- Vërtetimin për detyrimet
- Një kopje të programeve të lëndëve të shlyera

Me kërkesë të institucionit pritës të arsimit të lartë, shkolla e lartë private "Logos" përgatit edhe një karakteristikë me të dhëna të hollësishme mbi sjelljen dhe rezultatet e studentit për periudhën e frekuentimit nga ana e tij në këtë shkollë.

Neni 32 Diploma Universitare

1. Në përfundim të studimeve të ciklit të parë dhe pasi shlyen të gjitha detyrimet e përcaktuara në planin mësimor studentit, pajiset me diplomën universitare "Bachelor" në fushën përkatëse .

Studenti që përfundon programe studimi në Fakultetin Ekonomik pajiset përkatësisht me diplomat:

- "Bachelor" në fushën Financë Kontabilitet
- "Bachelor" në fushën Menaxhim Biznes

- "Bachelor" në fushën Menaxhim Turizmi

Studenti që përfundon programe studimi në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara pajiset perkatesisht me diplomat:

- "Bachelor" në fushën Informatike e Zbatuar
- "Bachelor" në fushën Teknik i Lartë në Laboratorët Mjekësorë

2. Dorëzimi i diplomave bëhet me ceremoni. Për studentët që mbarojnë studimet me medalje të Artë, organizohet një ceremoni dhe dorëzimi i diplomave bëhet nga Presidenti i Shkollës së Lartë Private "Logos" në prani të senatit dhe profesoriatit.

KREU VI

TE DREJTAT DHE DETYRAT E STUDENTËVE

Neni 33

Studenti e fiton këtë status me regjistrimin në Shkollën e Lartë Private "Logos" dhe e gëzon këtë status deri në:

- a. marrjen e diplomës;
- b. largimin e tij nga Shkolla e Lartë Private "Logos";
- c. përjashtimin e tij nga institucioni.

Studenti është i detyruar të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Statuti dhe rregullorja e kësaj shkolle të lartë.

Studenti ka të drejtë:

- a) të përfitojë nga procesi mësimor dhe të diplomohet, pasi të shlyejë të gjitha detyrimet e përcaktuara në planin mësimor, të përfitojë nga marrëveshjet e bashkëpunimit me shkollën të tjera universitare jashtë vendit që mundësojnë lëvizje reciproke të studenteve dhe të stafit akademik.
- b) të përdorë mjediset e shkollës së lartë për realizimin e programit mësimor;
- c) të organizohet në shoqata studentore jopolitike, sipas përcaktimeve të akteve ligjore përkatëse;
- d) të marrë pjesë në veprimtari artistike, kulturore, sportive, argëtuese të organizuara nga shkolla e lartë jashtë procesit mësimor;
- e) të ndikojë në përmirësimin e procesit mësimor, nëpërmjet formave demokratike të shfaqjes së vullnetit;
- f) të dëgjohet nga organizmat përkatëse, para se të merret ndonjë masë ndëshkuese kundër tij.

Studentët kanë të drejtë të organizohen edhe në këshilla studentorë, të cilët janë organizime të pavarur të studentëve në Shkollën e Lartë Private "Logos" dhe nuk zhvillojnë veprimtari politike dhe ekonomike. Këto këshilla promovojnë pjesëmarrjen e

studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e ideve dhe opinioneve të tyre në organet drejtuese të Shkollës së Lartë Private “Logos” në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve.

Këshilli i studentëve zgjidhet çdo vit nga votat e studentëve dhe mbështetet në legjislacionin në fuqi. Këshilli i studentëve organizohet në nivel institucioni me përfaqësues nga të gjitha fakultetet përbërëse. Modalitetet dhe procedurat për krijimin e tij përcaktohen në Rregulloren e institucionit.

Studenti ka detyrë:

- a) të zbatojnë rregullat e hartuara nga institucioni;
- b) t'u kushtojë vëmendjen e duhur studimeve dhe të marrë pjesë në veprimtaritë akademike;
- c) të paguajë tarifën e shkollimeve dhe të shërbimeve që u ofron Shkolla e Lartë “Logos”;
- d) të respektojnë rregullat e etikës të përcaktuara në rregulloren përkatëse;
- e) të tregojnë vëmendjen e duhur ndaj të drejtave të personelit dhe të studentëve të tjerë.

Studentet e institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë, në përputhje me ligjin e arsimit të lartë gëzojnë të drejtën të pajisen me kartën e studentit e cila është dokument unik. Me anë të kësaj karte studentet përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara.

KREU VII

PUNËSIMI DHE KUALIFIKIMI

Neni 34

Punësimi

Personeli në Institucionin e arsimit të lartë privat Shkolla e Lartë Private “Logos” përbëhet nga:

- a) personeli akademik (punonjësit mësimorë e shkencorë) të brendshëm e të jashtëm, i kategorizuar sipas nenit 47 të ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- b) personeli administrativ;
- c) personeli i shërbimit.

Vendet e punës për shkronjën “a” dhe “b” fitohen me konkurs.

Neni 35

Kontrata e punës

Kontrata e punës apo e shërbimit për personelin akademik lidhet nga Rektori i Institucionit.

Kontrata e punës për personelin në shërbim të Institucionit dhe personelin ndihmes lidhet nga Drejtuesi Ekzekutiv i Fondacionit.

Kontrata e punës me personelin akademik, të brendshëm lidhet me afat një vjeçar.
Kontrata e shërbimit me personelin akademik të jashtëm lidhet pa afat.
Kontrata e punës për gjithë personelin lidhet dhe zgjidhet sipas legjislacionit të punës.

Neni 36

Personeli akademik me kontratë

Shkolla e Lartë Private "Logos" punëson me kontratë personalitete, vendase ose të huaja, për periudha të shkurtra kohe. Miratimi për zgjedhjen e personelit akademik me kontratë bëhet nga Rektori.

Kriteret e mëtejshme të punësimit për personelin akademik me kontratë përcaktohen në Rregulloren e Institucionit.

Neni 37

Koha e punës dhe e pushimit

Koha e punës për personelin është jo më tepër se 40 orë në javë dhe jo më shumë se 8 orë në ditë. Kjo kohë punë mund të jetë më e shkurtër për personelin akademik.

Pushimi vjetor për punonjësit e brendshëm mësimorë e shkencorë është sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 220, datë 24.05.1994.

Problemet e tjera lidhur me kohën e punës dhe të pushimit përcaktohen në kontratën e punës, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 38

Norma mësimore shkencore

Punonjësit mësimorë e shkencorë janë të detyruar të plotësojnë normën mësimore shkencore, në përputhje kjo me udhëzimin nr.20 date 09. 05. 2008 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, "Për Veprimtarinë e Personelit Akademik Në Institucionet Publike Të Arsimit të Lartë" dhe sipas përcaktimeve në kontratën e punës. Kualifikimi shkencor dhe rezultatet në punë lidhen drejtpërsëdrejti me nivelin e pagës.

Mungesat e pajustificuara në orët mësimore konsiderohen shkelje të rënda të disiplinës në punë.

Neni 39

Kualifikimi

Personeli akademik gëzon të drejtën e kualifikimit shkencor, sipas kriterëve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave për kualifikimin shkencor pasuniversitar dhe për klasifikimin e punonjësve pedagogjikë e kërkimorë dhe në aktet e tjera nënligjore.

Ky kualifikim mund të bëhet brenda Shkollës së Lartë Private "Logos" ose jashtë saj, brenda ose jashtë vendit.

Kualifikimi shkencor për personelin akademik inkurajohet dhe promovohet dhe institucioni krijon lehtësitë e mundshme, sipas përcaktimeve në kontratën e punës.

KREU VIII

VULA ZYRTARE DHE STEMA

Neni 40

Institucioni i arsimit të lartë privat Shkolla e Lartë Private “Logos” ka vulën zyrtare ku shkruhet në pjesën e jashtme larte “REPUBLIKA E SHQIPËRISË”, në pjesën e brendshme Shkolla e Larte Private “ LOGOS” dhe ne pjesën e jashtë poshtë “TIRANE”.

Institucioni ka edhe stemën e vet me të njëjtin mbishkrim.

KREU IX

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 41

Bashkëlidhur me këtë Statut, Shkolla e Lartë Private “Logos” ka edhe Rregulloren e vet e cila rishikohet, kur shihet e arsyeshme nga shumica e anëtarëve të Senatit Akademik.

Për çdo program studimi Sh.L.P “Logos” harton rregulloret përkatëse, te cilat rishikohen kur del e nevojshme dhe kjo bëhet me vendim të Këshillit të Fakultetit që drejton programin e studimit.

Neni 42

Ndryshimet në normat që rregullojnë veprimtarinë e Sh.L.P” Logos” do të sjellin ndryshimin e statutit, gjithmonë në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9741 datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 43

Ky Statut u miratua nga Senati Akademik i Institucionit të arsimit të lartë privat Shkolla e Lartë “Logos” në mbledhjen e tij të radhës në datën 7/4/2011

Shtator 2011

